**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

## SHKURT 2026

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Nr. 3565 Prot | 20.02.2026 | Kërkoj të më vihen në dispozicion informacio-ni dhe dokumentat e mëposhtëm për lumenjtë dhe përrenjtë kryesorë të Parkut Shebenik–Jabllanicë: | 05.03.2026 | Referuar kërkesës per informacion për lumenjtë dhe përrenjtë kryesorë të Parkut Shebenik–Jabllanicë:<br>-Ne lidhje me piken1 dhe 2 ju informojme se<br>Në sistemin e leje ka aplikuar subjekti ″A**** ALBANIA‟, për projektin “M***** C*****,F**** S***”me Vendndodhja: Librazhd, Parku Kombëtar “Shebenik-Jabllanice”, Elbasan.<br>Aplikimi është bërë referuar Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,te<br>Ndryshuar, Shtojca II: Pika 12. Turizmi dhe koha e lirë. ç) Vendet për kampe të përhershme dhe karavane;<br>C) Fshatra turistike dhe komplekse hotelesh jashtë zonave urbane bashkë me zhvillimet që i shoqërojnë ato<br>Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatojë kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1- Ju lutemi të na vini në dispozicion:<br><br>● listën e VNM-ve të miratuara për projekte që prekin burimet ujore në zonën e Parkut Shebenik–Jabllanicë<br><br>● kushtet mjedisore që lidhen konkretisht me rrjedhën ekologjike.<br><br>2- A janë rishikuar ndonjëherë këto VNM ose Leje Mjedisore për shkak të:<br>- ndryshimit të kushteve hidrologjike<br>- ankesave nga komuniteti në ekosistemet | | ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.<br><br>Në zbatim te Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të ndryshuar.dhe VKM 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar<br>Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.<br><br>Për sa i përket pikës ku kërkohen monitorimet për Leje Mjedisore dhe VNM, lutem të bëhet me dije se për cilat subjekte (NIPT-e), kërkohen këto informacione.<br><br>Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C dhe licenca të nënkategorisë III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë".<br>Në linkun e mëposhtëm verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B:<br>https://qkb.gov.al/leje-licensa-autorizime/<br>Në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi Tipi A dhe B dhe licenca III.2.B për periudhën Janar 2014 - Janar 2026:<br>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/<br>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/ | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ujore?<br>3- Sa subjekte /operatorë që veprojnë:<br>a. brenda Parkut Kombëtar Shebenik–Jabllanicë<br>b. ose në zonën përreth /tamp-on janë të pajisur me Leje Mjedisore dhe janë të detyruar të dorëzojnë raporte periodike në AKM?<br>4- Për secilin subjekt, ju lutemi të na vini në dispozicion:<br>a. raportet e vetëmonitori-mit mjedisor<br>b. raportet e zbatimit të kushteve të Lejes | | Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë në Parkun Shebenik–Jabllanicë ka konstatuar dhe ka marrë masa administrative për dy subjekte.<br>1.Subjekti "B****&B" Dënim administrativ kryesor me gjobë në Vlerën 500.000 lekë dhe dënim administrativ plotësues Pezullim Aktiviteti.<br>2.Subjekti "C***" Dënim administrativ kryesor me gjobë në Vlerën 500.000 lekë dhe dënim administrativ plotësues Pezullim Aktiviteti. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mjedisore të dorëzuara për vitet 2018–2025.<br>5- Cila është periodiciteti ligjor i dorëzimit të këtyre raporteve dhe a ka raste kur:<br>a. raportet nuk janë dorëzuar<br>b. janë dorëzuar me vonesë?<br>6- A kryen AKM verifikim në terren për të kontrolluar saktësinë e:<br>○ raporteve të vetëmonitori-mit<br><br>○ të dhënave mbi prurjet ujore dhe rrjedhën ekologjike?<br>Nëse po:<br>○ sa verifikime | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në terren janë kryer nga AKM në Parkun Shebenik–Jabllanicë gjatë viteve 2018–2025?<br>○ në cilat raste konkrete dhe në cilat zona?<br>● Nëse jo, ju lutemi të sqaroni:<br>○ pse raportet e vetëmonitori-mit nuk verifikohen sistematik-isht<br>○ cili institucion konsideroh-et përgjegjës për këtë verifikim.<br>7 - A ka konstatuar AKM mospërpu-thje mes:<br>○ raporteve të vetëmonitori-mit të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dorëzuara nga operatorët<br>○ dhe të dhënave të marra nga institucione të tjera ose nga inspektime?<br>Nëse po, për sa raste bëhet fjalë dhe çfarë masash janë marrë nga AKM:<br>○ njoftim i ISHMPU<br>○ kërkesë për korrigjim raportimi<br>○ pezullim ose rishikim i Lejes Mjedisore?<br>8 - A janë raportet e vetëmonitori-mit dhe zbatimit të kushteve mjedisore:<br>a. të publikuara<br>b. të aksesueshm | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e për publikun? c. Nëse jo, cilat janë arsyet ligjore për mos-publikimin e tyre?<br>9. Cila është procedura e ndërveprim-it me IKMT kur konstatohen shkelje të lejes mbjedisore. Ka një procedurë të venë në vend? | | | | |
| 2. Nr. 3755 Prot | 25.02.2026 | 1-Në cilën periudhë është konstatuar shfrytëzimi i inerteve pa lejen përkatëse nga G*** shpk?<br>2-Për sa kohë ka ndodhur shfrytëzimi i inerteve nga G*** shpk? | 05.03.2026 | Në vijim të informacionit të kërkuar, ju bëjmë me dije si vijon:<br><br>1.Shfrytëzimi i inerteve është kostatuar në momentin e inspektimit në datë *13/02/2025*<br><br>2/3.Subjekti u konstatua duke shfrytëzuar inerte lumore në Paper-Elbasan, në afërsi të fshatit Muriqan , Njesia administrative Gjergjan,<br><br>4.Procesverbalin dhe Vendimin Përfundimtar të inspektimit për konstatimin e shkeljes i keni bashkangjitur. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3-Cilat janë koordinatat/ vendndodh-ja ku G**** shpk ka shfrytëzuar inerte të lumit Shkumbin pa lejen përkatëse? Specifikoni vendndodhj-en?<br>4-Ju lutem, vendosni në dispozicdion procesverbal in/dokument in e mbajtur në terren për konstatimin e shkeljes | | | | |
| 3. Nr. 3752 Prot | 25.02.2026 | Në vijim të letrës së hapur të iniciuar nga organizatat e shoqërisë civile dhe grupet lokale nënshkruese , po ju drejtohemi zyrtarisht për të kërkuar | 09.03.2026 | Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) Berat/Elbasan/Korçë, në vijim të kërkesës suaj për transparencë lidhur me ndërhyrjet në shtratin e Lumit Shkumbin përgjatë aksit Elbasan–Librazhd–Bushtricë, ju informojmë se institucioni ynë ka kryer inspektime të dedikuara për të verifikuar përputhshmërinë ligjore të subjekteve që operojnë në këtë segment.<br>Më konkretisht janë inspektuar subjektet si më poshtë:<br>1. Subjekti "A***." sh.p.k. (Inspektim mbi zbatimin e kushteve të VNM dhe Inspektim mbi zbatimin e kushteve të lejes së së zhfrytëzimit të materialeve inerte) – Inspektim me indicje të marra nga palët e treta.<br>Nga inspektimi i kryer në subjektin A*** shpk, u konstatua se subjekti është i pajisur me Vendim për VNM Paraprake, referuar Ligjit Nr.12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10440 Dt.07.07.2011 " Për Vlerësimin e Ndikimit në | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndërhyrje institucionale, monitorim të menjëhershëm dhe transparencë të plotë lidhur me ndërhyrjet e konstatuara në shtratin dhe brigjet e Lumit Shkumbin, në kuadër të punimeve për ndërtimin e rrugës Elbasan–Librazhd–Bushtricë. Bazuar në vëzhgime në terren dhe dokumentim të realizuar, janë evidentuar ndryshime në morfologjinë e lumit, nxjerrje materialesh inerte dhe | | Mjedis, Shtojca II: Pika 4. Industria nxjerrëse. ç. Nxjerrje e mineraleve nga marina ose llumërat lumore. Në momentin e inspektimit subjekti nuk ishte duke ushtruar aktivitetin e nxjerrjes së inerteve lumore, u konstatua se subjekti operonte në shkelje të pikës 3.11 të VNM-së "...rrethimi i zonës…", nuk u konstatuan sinjalistika paralajmëruese përgjatë segmentit të punimeve në zbatim të pikë 3.28. Trupa inspektuese dyshon se subjekti ka devijuar nga gjurmët e projektit. Përgjatë shtratit u konstatuan erozion i brigjeve të lumit. Subjekti nuk paraqiti dokumentacionin e mëposhtëm:<br>1. Dokumentacion i cili njofton fillimin e punimeve protokolluar pranë AKM-së.<br>2. Raportet e vetëmonitorimit të kryera sipas kushteve të përcaktuar në VNM-në që subjekti disponon, protokolluar pranë AKM-së.<br>3. Konfirmimin me topograf të licensuar se aktiviteti ushtrohet brenda kordinatave të përcaktuara në VNM-në që disponon (nuk ka dal nga koordinatat e përcaktuara).<br>Ndaj subjektit, në zbatim të pikës 1 dhe 2, të nenit 44, të Ligjit Nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", për shkeljet e kërkesave ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim në inspektimin e parë, si dhe i është lënë detyrë të dorëzoj pranë ARM Berat/Elbasan/Korçë, brenda 8 (tetë) ditëve nga marrja në djeni e procesverbalit të inspektimit, dokumentacionin e mëposhtëm:<br>1. Dokumentacion i cili njofton fillimin e punimeve protokolluar pranë AKM-së.<br>2. Raportet e vetëmonitorimit të kryera sipas kushteve të përcaktuar në VNM-në që subjekti disponon, protokolluar pranë AKM-së.<br>3. Konfirmimin me topograf të licensuar se aktiviteti ushtrohet brenda kordinatave të përcaktuara në VNM-në që disponon (nuk ka dal nga koordinatat e përcaktuara).<br>4. Kontestimet mbi konstatimet e trupës inspektuese.,<br>· Inspektimi për mbi zbatimin e kushteve të lejse për shfrytëzimin e materialeve inerte<br>Nga inspektimi i kryer u konstatuan shkelejet si më poshtë: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | depozitime dherash në afërsi ose brenda trupit ujor. Këto situata kërkojnë verifikim të plotë teknik dhe institucional për të garantuar përputh-shmërinë me legjislacion-in në fuqi dhe kushtet e lejeve përkatëse. Në këtë kuadër, kërkojmë: -Kryerjen e një inspektimi urgjnt në terrn dhe hartmin e një rapoti zyrtar me gjetje dhe masa konkete; -Verifikimin e përuthshmë- | | 1. Ligji Nr. 29/2024, datë 4.4.2024 "Për burimet ujore", Neni 144 pika 2: Në momentin e inspektimit të subjektit A N K në Njësinë Admininistrative Qëndër Librazhd, Bashkia Librazhd, në shtratin e lumit Shkumbin, u konstatuan 3 ekskavatrorë me zinxhira të cilët po punonin në shtratin e lumit Shkumbin duke devijuar rrjedhën e lumit në njërën anë të lumit. Këto veprime bien në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në Lejen Për Shfrytëzimin e Materialeve Inerte me Nr.000157 datë 27.12.2024, përkatësisht pika 8 " Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujor", dhe pika 9 "Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të Burimit Ujor.<br>2. Ligji Nr. 29/2024, datë 4.4.2024 "Për burimet ujore"-Neni 157 Veprimtaritë e ndaluara në brigje dhe plazhe, pika 1.a dhe c: Në momentin e inspektimit të subjektit A *** në Njësinë Admininistrative Qëndër Librazhd, Bashkia Librazhd, në shtratin e lumit Shkumbin u konstatuan depozitime masive të dherave dhe materialeve inerte të dala nga gërmimet e ndryshme të cilat arrinin deri në rrjedhën e lumit Shkumbin. Këto depozitime pëngojnë rrjedhën natyrale të lumit, ndryshojnë ose zhvendosin e mbulesën bimore natyrale apo artificiale.<br>Ndaj subjektit, në zbatim të Ligji Nr. 29/2024, date 4.4.2024 "Për burimet ujore", Neni 169 pika1.n) veprimtaritë e kryera në kundërshtim me pikën 3, të nenit 131, dhe të neneve 156 e 157, të këtij ligji, lidhur me depozitimin e materialeve dhe substancave, si dhe ndërtimin e objekteve të reja në zonat e rrezikuara nga përmbytjet, ndërtimin, rindërtimin ose shembjen e objekteve të mbrojtjes së brigjeve apo veprave të tjera në brigje pa autorizimet përkateëe, si dhe veprimtaritë e ndaluara në brigje dhe plazhe përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga 1 000 000 Lekë deri në 2 000 000 Lekë;<br>Ligji Nr. 29/2024, datë 4.4.2024 "Për burimet ujore" neni 169 pika1 i) veprimet e kryera nga përdoruesi, në kundërshtim me shkronjat "a", "b", "c", "c" dhe "d" të pikës 2 të nenit 144 të këtij ligji lidhur me respektimin e kushteve të përgjithshme të lejes apo autorizimit përbëjnë kundërvajtje administrative dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | risë së ndërhyrjeve me lejet për përorim burimi ujor dhe kushtet e Vlersimit të Ndikimit në Mjedis;<br>- Monitorimin e cilësisë së ujit dhe sedimenteve në segmentet e prekura;<br>-Vënien në dispozicion të dokumenta-cionit përkatës sipas detyrimeve të transparenc-ës dhe të drejtës së informimit.<br>Ne e konsideroj-më këtë çështje si me rëndësi të lartë për mbrojtjen e mjedisit, | | ndëshkohen me gjobë nga 1 000 000 Lekë deri 2 000 000 në Lekë;<br>Është marrë masë administrative Gjobe: 1,000,000 Lekë si dhe janë lënë detyrat si më poshtë:<br>Subjekti të mos depozitojë dhera apo materiale të ndryshme në brigjet apo shtratin e lumit Shkumbin, jashtë vend depozitimeve të miratuara për hedhjen e tyre. Të marrë masa te menjëhershme për heqjen e dherave apo materialeve inerte të ndryshme që ka hedhur në shtratin dhe bregun e lumit dhe ti depozitojë ato vetëm në vend depozitimet e miratuara dhe brenda kordinatave te përcaktuara në to sipas përcaktimeve dhe në zbatim të neneve 156 dhe 157 të Ligjit Nr.29/2024 “Për Burimet Ujore”. Subjekti të zbatojë të gjitha kushtet e lejes Për Shfrytëzimin e Materialeve Inerte me Nr.000157 datë 27.12.2024 që disponon . Të mos ushtrojë veprimtari në kundërshtim me kushtet e lejes dhe ligjit Ligji Nr. 29/2024, datë 4.4.2024 “Për burimet ujore”.<br>Në të dy inspektimet e kryera në subjektin A*** sh.p.k, ARM Berat/Elbasan/Korçë nuk ka dal me vendimin përfundimtar pasi referuar Nenit 43 të Ligjit 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” ende nuk janë plotësuar afatet ligjore.<br>Subjekti " G***" sh.p.k.<br>Nga Inspektimi i kryer në Subjektin " G***" sh.p.k. u konstatua se kamione dhe eskavatore te subjektit “G***” po nxirrnin materiale inerte nga lumi Shkumbin përgjatë shtratit të lumit, të cilat i përdornin për ndërtimin e rrugës Korridori i 8 loti 2 Paper-Elbasan, në afërsi të fshatit Muriqan , Njësia Administrative Gjergjan, Subjekti nuk na paraqiti leje për shfrytezimin e materialeve inerte nga organet e menaxhimit dhe administrimit te burimeve ujore.<br>Gjetjet e konstatuara bjen në kundërshtim me ligjin dhe me vendim përfundimtar dhe në mbështetje të ligjit Ligji 29/2024 "Për Burimet Ujore" Neni 169 ndaj subjektit është marr masë administrative Gjobë: 1,000,000 Lekë dhe është lënë detyrë “Subjekti të pezulloje menjehere veprimtarine e shfrytezimit te inerteve lumore deri ne paraqitjen e lejeve perkatese nga | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sigurinë territoriale dhe interesin publik. Qasja jonë nuk është kundër zhvillimit infrastruktur-or, por në mbështetje të një zhvillimi të përgjegjsh-ëm, të bazuar në ligj dhe në standarde të qarta teknike. Jemi të gatshëm të bashkëpunoj-më me institucionet përkatëse dhe të kontribuoj-më me dokumentim-in dhe informacion-in që disponojmë, në funksion të një procesi | | organet e menaxhimit dhe administrimit te burimeve ujore si dhe te zbatoje kerkesat ligjore per ushtrimin e veprimtarise.”<br>2. Subjekti " I*****" – me objekt “Në trajtim të shkresës me Nr. 705/4 Prot., Datë 15.05.2025”<br>Në trajim të ankesës së protokolluar pranë ARM Berat/Elbasan/Korce me Nr.705/4., Date:15.05.2025, dhe në zbatim të programit të punës me Nr.705/3, Datë:16.05.2025 u krye verrifikimi në terren i situatës. Nga kontrolli i kryer përgjatë shtratit të lumit në zonën ku referohej ankesa, në shtratin e lumit dhe brigjet e tij u konstatuan 2 ekskavatorë CAT të subjektit I*****. Ekskavatorët ndodheshin në lumin Shkumbin në segmentin përballë kantierit të subjektit. Në momentin e inspektimit ekskavatorët ishin të fikur, por në zonën rreth ekskavatorit u konstatuan disa gropa të cilat tregojnë qartë që janë marrë inerte lumore. Gjithashtu rruga që lidh kantierin e subjektit I***** me lumin kishte gjurmë kamionash.<br>Gjetjet e konstatuara bjen në kundërshtim me ligjin dhe me vendim përfundimtar, dhe në zbatim të pikës 1 dhe 2, të nenit 44, të Ligjit Nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", për shkeljet e kërkesave ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmerim në inspektimin e parë. Ndaj subjektit është marr masa Dënim Administrativ Kryesor : Paralajmërim, dhe është lënë detyrë “Subjekti te largoje menjehere ekskavatoret nga shtrati i lumit si dhe mos te marre inerte lumore apo te ushtroje veprimtari ne shtarin e lumit apo brigjet e tij, pa u pajisur më parë me lejen përkatëse nga organet e menaxhimit të burimeve ujore. - Subjekti të mos ushtrojë veprimtari në kundërshtim me Ligjin Nr.29/2024 " Për Burimet Ujore" . Të shfrytezojë inerte lumore dhe të mos kryejë veprimtari të ndaluara në lumë apo brigjet e tij.”<br>Lidhur me kërkesën për monitorimin e cilësisë së ujit dhe sedimenteve, ju sqarojmë se ky proces nuk është pjesë e funksionit dhe kompetencës së Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) Berat/Elbasan/Korçë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | transparent dhe profesional. | | Bashkëngjitur do të gjeni të gjitha praktikat e plota inspektuese (autorizimet, procesverbalet dhe vendimet) të cilat u cituan më sipër.<br>Agjencia Rajonale e Mjedisit mbetet plotësisht e hapur për bashkëpunim të mëtejshëm me shoqërinë civile dhe strukturat lokale, në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe transparencës ndaj publikut. Jemi në dispozicionin tuaj për çdo informacion tjetër plotësues që mund t'ju nevojitet. | | |
| 4. Nr. 3856 Prot | 27.02.2026 | Kërkoj të më vihen në dispozicion informacioni dhe dokumentat e mëposhtëm:<br><br>1- Sa rezervuarë dhe diga janë në administrim të Bashkisë Tiranë?<br><br>2- Sa prej tyre janë aktive, jashtë funksionit ose me funksion të ndryshuar (rekreacion, park, ujitje)? | 27.02.2026 | Pyetjet e adresuara janë jashtë fushës së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, referuar VKM-së Nr.568/2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3-Specifikisht për rezervuarin e Tufinës:<br><br>○ A ka humbur rezervuari i Tufinës funksionin për shkak të mbushjes me sedimente?<br><br>○ A ka Bashkia Tiranë:<br><br>● raporte teknike për sedimentim-in?<br><br>● vlerësim risku për sigurinë e digës?<br><br>○ Çfarë projekti konkret ka paraqitur Bashkia Tiranë pranë KKDM për | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | këtë rezervuar?<br><br>● A është miratuar nga KKDM?<br><br>● A ka marrë Bashkia ndonjë masë alternative pas mosmiratim-it?<br><br>4- Specifikisht për rezervuarin e Liqenit Artificial<br><br>- A është e vërtetë që shkarkuesi i digës është i bllokuar pjesërisht ose plotësisht nga zhvillimi urban poshtë saj? | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - Sa leje ndërtimi janë dhënë:<br><br>● në zonën e shkarkuesit?<br><br>● mbi ose në afërsi të trupit të digës?<br><br>- A ka miratuar Bashkia/ Apo ka qenë e konsultuar nga KKT për leje ndërtimi mbi shkarkuesin e<br><br>digës?<br><br>- A ekziston një leje ndërtimi për objekt multifunksio-nal që parashikon mbështetjen e një ure mbi digën e rezervuarit | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të Liqenit Artificial?<br><br>- A janë kërkuar mendime teknike nga KKDM për këto leje?<br><br>- Kur është kryer inspektimi i fundit teknik për digën e Liqenit Artificial?<br><br>- A ka raporte që evidentojnë:<br>■ deformime?<br>■ çarje?<br><br>■ probleme strukturore?<br>- A ka Bashkia analiza të fundit për ndotjen bakteriale të Liqenit Artificial? | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ○ A janë këto të dhëna publike?<br><br>○ A konsideroh-et liqeni i sigurt për aktivitete rekreative? | | | | |
| 5. Nr. 3941 Prot | 02.03.2026 | 1. A janë pajisur subjektet që kanë kryer gërryerje në lumin Shkumbin me leje mjedisore për këtë aktivitet? Nëse po, cilat janë këto subjekte të pajisua me lejen përkatëse?<br><br>2. Çfarë kategorie lejeje mjedisore është dhënë dhe në çfarë | 02.03.2026 | Referuar objektit të kërkesës ju informojmë se sektori i shqyrtimit teknik për veprimtaritë në mjedis shqyrton aplikimet për Leje Mjedisi Tipi A dhe B.<br>Sipas kërkesës suaj ju informojmë se veprimtaria e gërryerjes në lumin Shkumbin nuk është pjesë e veprimtarive të përcaktuara në shtojcën 1 të Ligjit Nr.10448/2011 "Për lejet e mjedisit".<br><br>Në kërkesë nuk specifikohen subjektet për të cilat kërkohet informacion. Megjithatë ju bëjmë me dije se AKM, shqyrton aplikime në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, aplikime të ardhura në sistemin e_leje, në e_Albania.<br><br>Listën e punëve publike për ndërtimin e rrugëve me rëndësi kombëtare dhe rajonale, që kanë domosdoshmëri përdorimin e inerteve lumore e harton Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Subjektet të cilat kanë kontrata me ARRSH dhe kryejnë punime, aplikojnë në e-Albania referuar Ligjit Nr.12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 4. Industri nxjerrëse. ç) Nxjerrje e mineraleve nga marina ose llumërat lumore. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | periudhe kohore është e vlefshme?<br><br>3. A është kryer Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) për këto aktivitete?<br><br>4. A ka kryer AKM monitorime apo inspektime në terren për këto ndërhyrje?<br><br>5. A janë konstatuar shkelje të kushteve mjedisore dhe çfarë masash janë marrë?<br><br>6. A ka pasur pezullim apo revokim të lejeve mjedisore | | Gjithashtu në lidhje me Autorizimet për shfrytëzimin e materialeve inerte referuar Ligjit Nr.29/2024 "Për burimet ujore" i ndryshuar, duhet ti drejtoheni Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.<br>Lidhur me informacionin e kërkuar, në bazë të inspektimeve të kryera, sektori i inspektimit të Burimeve Natyrore ka kryer 2 (dy) inspektim në lidhje me subjektet që punojnë për projektin e rrugës Elbasan- Qafë Thanë. Inspektimi është realizuar si pasojë e indicios të marrë nga palë të treta:<br>- Nga inspektimi i kryer në subjektin G**** shpk rezultoi se shfrytëzonte inerte nga shtrati i lumit shkumbin pa lejen perkatëse nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore. Lidhur me shkeljen e konstatuar ndaj subjektit është vendosur masa e dënimit administrativ me gjobë 1 000 000 Lekë, si dhë Vendimin e Ndërmjetëm për Marrjen e Masës Urgjente për pezullimin e veprimtarisë së marrjes së inerteve lumore .<br>- Nga inspektimi i kryer në subjektin A*** shpk rezultoi se shfrytëzonte inerte nga shtrati i lumit dhe depozitonte materjale inerte ne shtratin e lumit shkumbin pa lejen përkatëse nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore. Lidhur me shkeljen e konstatuar ndaj subjektit është vendosur masa e dënimit administrativ me gjobë 1 000 000 Lekë.<br>- Nga inspektimi i kryer në subjektin A*** shpk i cili është pajisur me Vendim për VNM në funksion të shfrytëzimit të inerteve nga shtrati i lumit u konstatua se subjekti nuk ishte duke ushtruar aktivitetin e nxjerrjes së inerteve lumore, u konstatua se subjekti operonte në shkelje të pikës 3.11 të VNM-së "...rrethimi i zonës…", nuk u konstatuan sinjalistika paralajmëruese përgjatë segmentit të punimeve në zbatim të pikë 3.28. Trupa inspektuese dyshon se subjekti ka devijuar nga gjurmët e projektit. Përgjatë shtratit u konstatuan erozion i brigjeve të lumit. Subjekti nuk paraqiti dokumentacionin e mëposhtëm:<br>1. Dokumentacion i cili njofton fillimin e punimeve protokolluar pranë AKM-së. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për këto kompani?<br><br>7. Cili është komenti juaj lidhur me pretendimet të banorëve të zonës dhe ekspertëve të cilët e lidhin rrënimin e rrugës me shgrytëzimin jashtë kritereve në inerteve dhe gërryerjeve ne lumin Shkumbin? | | 2. Raportet e vetëmonitorimit të kryera sipas kushteve të përcaktuar në VNM-në që subjekti disponon, protokolluar pranë AKM-së.<br>3. Konfirmimin me topograf të licensuar se aktiviteti ushtrohet brenda kordinatave të përcaktuara në VNM-në që disponon (nuk ka dal nga koordinatat e përcaktuara).<br>Ndaj subjektit, në zbatim të pikës 1 dhe 2, të nenit 44, të Ligjit Nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", për shkeljet e kërkesave ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmerim në inspektimin e parë, si dhe i është lënë detyrë të dorëzoj pranë ARM Berat/Elbasan/Korçë, brenda 8 (tetë) ditëve nga marrja në djeni e procesverbalit të inspektimit, dokumentacionin e mëposhtëm:<br>1. Dokumentacion i cili njofton fillimin e punimeve protokolluar pranë AKM-së.<br>2. Raportet e vetëmonitorimit të kryera sipas kushteve të përcaktuar në VNM-në që subjekti disponon, protokolluar pranë AKM-së.<br>3. Konfirmimin me topograf të licensuar se aktiviteti ushtrohet brenda kordinatave të përcaktuara në VNM-në që disponon (nuk ka dal nga koordinatat e përcaktuara).<br>4. Kontestimet mbi konstatimet e trupës inspektuese.<br>Grupi i inspektimit nuk ka dal me vendimin përfundimtar pasi referuar Nenit 43 të Ligjit 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” ende nuk janë plotësuar afatet ligjore. | | |
| 6. Nr. 3989 Prot | 03.03.2026 | Kërkojmë nga ana juaj përgjigjen e pyetjeve të mëposhtëme:<br><br>1. Një kopje të dokumentit | 05.03.2026 | Në vijim të kërkesës për dokumentacion në lidhje me projektin e resortit “B*** B****” në zonën e Baks-Rrjoll, Bashkia Shkodër, gjeni bashkëlidhur Deklaratën Mjedisore, Dëgjesën me publikun dhe Raportin e Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | “Vlerësimi i Plotë i Ndikimit në Mjedis (VNM)” për resortin me 5 yje “B*** B****”.<br><br>2. Një kopje të dokumentit “Deklarata Mjedisore” për projektin “B*** B***” në zonën e Baks-Rrjollit, Bashkia Shkodër.<br><br>3. Një kopje të listëprezenc-ës së konsultime-ve publike të zhvilluara me banorët e zonës së Rrjollit për projektin “B*** B***” në zonën e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Baks-Rrjollit, Bashkia Shkodër. | | | | |
| 7. Nr. 3986 Prot | 03.03.2026 | Me qëllim evidentimin e plotë të rrjedhës së trajtimit të mbetjeve të llojit produkte ushqimore të papërshtatshme, nga ana jonë është kërkuar nga AKM, për vitin 2025, informacion i detajuar si më poshtë:<br>1. Numrin e operatorëve të biznesit ushqimor (OBU) të ndryshëm që kanë njoftuar AKM për procedura asgjësimi të produkteve ushqimore | 17.03.2026 | Në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, ligjit nr. 57/2025, datë 16.10.2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Vendim nr. 402, datë 30.6.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", VKM nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", VKM nr. 371, datë 11.6.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", VKM nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br><br>1. Sasia totale (në kg/ton) të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të trajtuara përmes industrisë së përpunimit dhe sasia totale e depozituar në landfill, kërkuesit i është dërguar me shkresën Nr.3570 prot datë 23.02.2026<br><br>2. Mbetjet të cilat nuk janë trajtuar përmes industrisë së përpunimit janë depozituar në landfill industrial të pajisur me leje, licenca dhe kodet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me origjinë shtazore;<br>2. Numrin e njoftimeve të bëra ndaj AKM për procedura asgjësimi të produkteve ushqimore me origjinë shtazore nga AKU;<br>3. Numrin total të procedurave faktike të asgjësimit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të dokueentuara nga strukturat e AKM.<br>4. Sasitë totale (në kg/ton) të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të asgjësuara sipas këtyre procedurave; | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5. Mënyrën e asgjësimit të tyre (përmes industrisë së përpunimit apo depozitimit në landfill);<br>6. Në cilat landfill-e janë depozituar këto produkte, në rastet kur është ndjekur kjo mënyrë dhe sasitë përkatëse;<br>7. Nëse është e mundur, ndarjen e këtyre të dhënave sipas muajve dhe sipas rajoneve.<br><br>Nga sa më sipër, lutemi të na informoni për: | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.Sasinë e nënprodukte-ve shtazore dhe produkteve ushqimore që janë ricikluar dhe për ato që janë depozituar në landfill;<br>2.Landfill-et konkrete ku janë hedhur këto mbetje; | | | | |
| 8. Nr. 4024 Prot | 03.03.2026 | 1.A është inspektuar Spitali Rajonal i D**** për menaxhimin e mbetjeve spitalore në pesë vitet e fundit 2020-2025?<br><br>2-A janë konstatuar shkelje në lidhje me magazinim-in, transportin dhe | 18.03.2026<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>*31.03.2026* | Në vijim të informacionit të kërkuar, për subjektin “Spitali D***” për Lejen Mjedisore Tipi B, ku ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br>Në pesë vitet e fundit (periudha 2020–2025), sipas sistemit e-inspektimi.gov.al, "Spitali D***" nuk është inspektuar, por do të jetë pjesë e subjekteve të planifikuara nga ana e institucionit tonë për kontroll të kritereve dhe zbatimit të kushteve të Lejes Mjedisore.<br>“Spitali Durrës” kryen transportin e mbetjeve sipas kontratave me subjekte të licencuar me licencat përkatëse.<br>Subjektet që janë të pajisur me leje mjedisi janë objekt kontrolli nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.<br><br><br><br>*Info shtesë*<br>Në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi, Ligji Nr. 99, datë 12.09.2024, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 10431, datë 9.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, Ligji Nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | asgjësimin e mbetjeve spitalore në këtë spital? Nëse po, cilat masa administrati-ve janë marrë?<br><br>3-Cili është operatori i licencuar që trajton mbetjet spitalore të Spitalit Rajonal D*** dhe a është ai subjekt i kontrolleve nga AKM? | | mjedisit” të ndryshuar, Ligji Nr.57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” dhe Ligji Nr. 111, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” të ndryshuar, Vendimit nr. 798, datë 29.09.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore“, si dhe VKM, Nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ju informoj për sa vijon:<br>Nga inspektimi i kryer pranë Spitalit Rajonal D*** me datë 30.03.2026, me objekt veprimtarie Spital. Operatori është i pajisur me leje mjedisi të tipit B për aktivitet spital.<br>Nga inspektimi në terren u konstatua se operatori grumbullimin, seleksionimin, ndarjen, trasnportimin dhe depozitimin e mbetjeve spitalore deri në vendepozitimin provizor e kryen sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuar në Vendimit nr. 798, datë 29.09.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore.<br>Operatori ka kryer dhe dorëzuar në institucionet kopetente:<br>1. raportin e vetmonitorimit per shkarkimet ne mjedis<br>2. raporti vjetor per shkarkimet ne mjedis<br>3. Tarifën vjetore të lejes mjedisore<br>Operatori dispononte kontratë shërbimi për evadimin e mbetjeve spitalore, dokumentin e transferimit të mbetjeve të rrezikshme sipas VKM-ve respektive Operatori dispononte kontratë shërbimi për evadimin e mbetjeve urbane dhe dokumentin e transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme sipas VKM-ve respektive. | | |
| 9.<br>Nr.<br>3901<br>Prot | 02.03.20<br>26 | -A keni një projekt për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme | 04.03.2026 | Duke qenë se objekti në të cilin është vendosur të depozitohen mbetjet është i sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërhyrja nga organi administrativ Agjencia Kombëtare e Mjedisit është e kufizuar për shkaqe që lidhen me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në Porto Romano, ose dërgimin në bazë të rregullave dhe kushteve specifike në një shtet tjetër i cili përpunon mbetje të tilla?<br>-Nëse keni një projekt, sa është kosto financiare ?<br>-Deri në zgjidhjen e plotë të rastit, a keni kryer verifikim në c'farë kushtesh po mbahen mbetjet, a ka rrezik kontaminimi në zone? | | | | |
| 10 Nr. 4056 Prot | 04.03.2026 | Me qëllim evidentimin e plotë të rrjedhës së trajtimit të | 17.03.2026 | Në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, ligjit nr. 57/2025, datë 16.10.2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Vendim nr. 402, datë 30.6.2021 "Për | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbetjeve të llojit "produkte ushqimore të papërshtat-shme" nga ana jonë është kërkuar nga AKM për vitin 2025, informacion si më poshtë:<br><br>1-Numrin e operatorëve të biznesit ushqimor (OBU) të ndryshëm që kanë njoftuar AKM për procedura asgjësimi të produkteve ushqimore me origjinë shtazore;<br><br>2-Numrin e njoftimeve të bëra ndaj AKM për procedura asgjësimi të | | miratimin e katalogut të mbetjeve", VKM nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", VKM nr. 371, datë 11.6.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", VKM nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br><br>1. Sasia totale (në kg/ton) të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të trajtuara përmes industrisë së përpunimit dhe sasia totale e depozituar në landfill, kërkuesit i është dërguar me shkresën Nr.3570 prot datë 23.02.2026<br><br>2. Mbetjet të cilat nuk janë trajtuar përmes industrisë së përpunimit janë depozituar në landfill industrial të i pajisur me leje, licenca dhe kodet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | produkteve ushqimore me origjinë shtazore nga AKU;<br><br>3-Numrin total të procedurave faktike të asgjësimit të produkteve ushqimore me origjinë të dokumentuara nga strukturat e AKM;<br><br>4-Sasitë totale ( në kg/ton) të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të asgjësuara sipas procedurave ;<br><br>5-Mënyrën e asgjësimit të tyre (përmes industrisë së përpunimit | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | apo depozitimit në landfill);<br><br>6-Në cilat landfill-e janë depozituar këto produkte, në rast kur është ndjekur kjo mënyrë dhe sasitë përkatëse;<br><br>7-Nëse është e mundur, ndarjen e këtyre të dhënave sipas muajve dhe sipas rajoneve.<br><br>Nga sa më sipër, lutemi na informoni për:<br><br>1-Sasitë e nënprodukteve shtazore dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | produkteve ushqimore që janë ricikluar dhe për ato që janë depozituar në landfill;<br><br>2-Landfill-et konkrete ku janë hedhur këto mbetje; | | | | |
| 11. Nr. 4124 Prot | 05.03.2026 | Kërkojmë një takim mundësisht me drejtues të AKM apo zyrtarë të tjerë me të cilët mund të diskutojmë disa cështje që lidhen me mjedisin. | 13.03.2026 | Në vijim të informacionit të kërkuar nga ana juaj, administuar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Nr.4124 Prot datë 05.03.2026,<br>Ju presim në ambientet e institucionit, ditën e Martë, datë 17.03.2026 ora 12:00. | Përfunduar | Nuk ka |
| 12. Nr. 4073 Prot | 04.03.2026 | 1-A ka bërë institucioni juaj një analizë të situatës së shfrytëzimit të lumenjëve | 06.03.2026 | Sipas kuadrit ligjor në fuqi, shfrytëzimi i materialeve inerte nga shtrati i lumenjve është aktivitet që licencohet/autorizohet nga organet përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, jo nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Ligji nr. 29/2024 “Për burimet ujore” përcakton kuadrin institucional për administrimin dhe përdorimin e burimeve ujore, duke përfshirë dhënien e lejeve për përdorim të ujit dhe ndërhyrje në trupat ujorë, përmes Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshillave të Baseneve dhe | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për inerte që ndodhen në qarkun Durrës ? Po në rastet kur ata kanë kërcënuar objekte të rëndësisë së vecantë: si rrugë apo ura kujt i jeni drejtuar ?<br><br>2-A ka institucioni juaj një raport të situatës së shfrytëzimit të lumenjve për inerte? Sa është sasia e inerteve të marra nga lumenjtë në 3 dekadat e fundit?<br><br>3-A keni bashkëpunuar me institucionet e tjera locale për tu ndaluar apo | | strukturave përkatëse. Në këtë kontekst, AKM nuk ka kompetencë të japë leje për marrjen e inerteve nga lumenjtë, as të autorizojë ndërhyrje në shtrat/brigje lumenjsh. Roli i saj në inspektim-kontroll përfshin kryerjen e inspektimeve mjedisore vetëm në rastet kur shkeljet lidhen me kushtet e lejeve mjedisore/ lejeve të shfrytëzimit të lumenjve;<br><br>AKM nuk disponon të dhëna zyrtare për sasinë e inerteve të nxjerra nga lumenjtë në 30 vitet e fundit dhe lejet e dhëna për shfrytëzim (të cilat nuk janë kompetencë e AKM). Këto të dhëna administrohen nga strukturat e qeverisjes së burimeve ujore të përcaktuara në ligjin nr. 29/2024. AKM nuk ka kompetencë hetimore për analizimin teknik të rasteve kur lumenjtë kanë rrezikuar infrastrukturën rrugore apo urat;<br><br>Ndërhyrjet në shtratin dhe brigjet e lumenjve, përfshirë marrjen e paligjshme të inerteve ose punimet pa leje, që rrezikojnë infrastrukturën rrugore dhe urat, nuk janë në kompetencën e AKM. Për këto raste, përgjegjësitë ligjore i kanë:<br><br>IKMT është organi qendror përgjegjës për parandalimin dhe ndëshkimin e ndërtimeve/ndërhyrjeve të paligjshme në territor, përfshirë shtratin e lumenjve<br><br>IMT-të pranë bashkive<br><br>Pushteti vendor (bashkitë)<br><br>Edhe pse AKM nuk ka kompetenca për të ndërhyrë në ndërhyrjet fizike në territor, ne bashkëpunojmë me strukturat përgjegjëse kur evidentohen ndikime mjedisore, ndotje ose shkelje të kushteve të lejeve mjedisore. Ky bashkëpunim është formalizuar edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të datës 13.02.2025 ndërmjet AKM – IKMT – AMBU, që synon:<br><br>• shkëmbimin e informacionit në kohë reale;<br>• koordinimin në verifikimet në terren;<br>• rritjen e efektivitetit të kontrolleve për zbatimin e lejeve mjedisore dhe kushteve ligjore; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | frenuar shfrytëzimin e inerteve të lumenjeve ? | | • referimin e rasteve që bien jashtë kompetencës së AKM te IKMT, AMBU ose pushteti vendor.<br><br>Në lidhje me ndërhyrjet që rrezikojnë infrastrukturën, AKM:<br><br>• nuk ka kompetenca ndëshkimore për ndërhyrje fizike në shtrat lumenjsh;<br>• kryen vetëm verifikime për ndikimet mjedisore, sipas fushës sonë të veprimit;<br>• referon rastet te IKMT/IMT kur konstaton ndërhyrje të paligjshme që cenojnë territorin;<br>• raporton te AMBU dhe strukturat e ujërave në rast të dyshimeve për mungesë/tejkalim të kushteve të lejeve të përdorimit të ujit. | | |
| 13. Nr. 4338 Prot | 11.03.2026 | 1. Listën e plotë të lejeve mjedisore të miratuara për aktivitete të nxjerrjes së inerteve ose gërmimeve në shtratin e lumenjve në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë pesë viteve të fundit.<br><br>2. Emrat e subjekteve | 27.03.2026 | Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë".<br>Në linkun e mëposhtëm mund të verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B:<br>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/<br>Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, ka për qëllim të sigurojë aksesin e lirë të publikut në përputhje me ligjin.<br>Gjithashtu ju informojmë se në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi periudha 2014-2026:<br>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/<br><br>Vendimet e VNM sipas link | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përfituese të këtyre lejeve, vendodhjen e aktivitetit (lumi dhe segmenti përkatës), si dhe afatin e vlefshmërisë së lejes.<br>3.Dokument acionin përkatës të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për këto aktivitete, në rastet kur është kryer një vlerësim i tillë.<br>4. Informacion mbi kontrollet, inspektimet ose monitorimet e kryera nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit lidhur me zbatimin e kushteve të | | https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-vnm-te-per-periudhen-janar-2014-qershor-2024/<br>Për informacion më të detajuar, lutemi specifikimin e subjekteve me PN-të përkatëse, me qëllim evidentimin e tyre për raportet e vetëmonitorimit.<br><br>Nga ARM ARM Tiranë; Lezhë dhe Fier bëhet me dije nuk kanë kryer inspektime në subjektet me aktivitet të nxjerrjes së inerteve pranë shtrateve të lumenjve, pasi aktivitete të tilla nuk bëjnë pjesë në Shtojcën 1 të Ligjit Nr.52/2020, për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar, për aktivitete që duhet të pajisen me leje mjedisore të tipit A dhe B.<br><br>Në zbatim të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", Agjencitë Rajonale të Mjedisit kryejnë inspektime për kontrollin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore dhe kërkesave ligjore.<br><br>Gjithashtu sa i përket paligjshmërisë IKMT është institucioni që inspekton dhe merr masa për këto aktivitete.<br><br>Ndër të tjeta, Agjencia Rajonale e Mjdisit Berat informon se në  bazë të inspektimeve të kryera, sektori i inspektimit të Burimeve Natyrore ka kryer 2 (dy) inspektime në lidhje me subjektet që punojnë për projektin e rrugës Elbasan- Qafë Thanë. Inspektimi është realizuar si pasojë e indicios të marrë nga palë të treta:<br>1. **Nga inspektimi i kryer ne subjektin G*** shpk** rezultoi se shfrytëzonte inerte nga shtrati i lumit shkumbin pa lejen perkatëse nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore. Lidhur me shkeljen e konstatuar ndaj subjektit është vendosur masa e dënimit administrativ me gjobë 1 000 000 lekë, si dhë Vendimin e Ndërmjëm për Marrjen e Masës Urgjente për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lejeve mjedisore për këto aktivitete, si dhe çdo raport apo akt-konstatim të përpiluar gjatë këtyre verifikimeve.<br>5.Çdo raport monitorimi apo dokument tjetër zyrtar që lidhet me ndikimin mjedisor të aktivitetit të nxjerrjes së inerteve në lumenjtë e vendit. | | pezullimin e veprimtarisë së marrjes së inerteve lumore .<br><br>2. **Nga inspektimi i kryer ne subjektin A*** shpk** rezultoi se shfrytëzonte inerte nga shtrati i lumit dhe depozitonte materjale inerte ne shtratin e lumit shkumbin pa lejen perkatëse nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore. Lidhur me shkeljen e konstatuar ndaj subjektit është vendosur masa e dënimit administrativ me gjobë 1 000 000 lekë.<br><br>3. **Nga inspektimi i kryer ne subjektin A*** shpk** i cili eshte pajisur me Vendim per VNM ne funksion te shfrytezimit te inerteve nga shtrati i lumit (me nr. AN200220240003) u konstatua se subjekti nuk ishte duke ushtruar aktivitetin e nxjerrjes së inerteve lumore, u konstatua se subjekti operonte në shkelje të pikës 3.11 të VNM-së "...rrethimi i zonës…", nuk u konstatuan sinjalistika paralajmëruese përgjatë segmentit të punimeve në zbatim të pikë 3.28. Trupa inspektuese dyshon se subjekti ka devijuar nga gjurmët e projektit. Përgjatë shtratit u konstatuan erozion I brigjeve të lumit. Subjekti nuk paraqiti dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Dokumentacion i cili njofton fillimin e punimeve protokolluar pranë AKM-së. 2. Raportet e vetëmonitorimit të kryera sipas kushteve të përcaktuar në VNM-në që subjekti disponon, protokolluar pranë AKM-së. 3. Konfirmimin me topograf të licensuar se aktiviteti ushtrohet brenda kordinatave të përcaktuara në VNM-në që disponon (nuk ka dal nga koordinatat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përcaktuara). Ndaj subjektit, në zbatim te pikes 1 dhe 2, te nenit 44, te ligjit nr. 99/2024, date 12.09.2024, "Per inspektimin ne Republiken e Shqiperise", per shkeljet e kerkesave ligjore qe perbejne kundervajtje administrative, subjekti i inspektimit denohet me **paralajmerim** ne inspektimin e pare, si dhe i është lënë detyrë të dorëzoj pranë ARM Berat/Elbasan/Korçë, brenda 8 (tetë) ditëve nga marrja në djeni e procesverbalit të inspektimit, dokumentacionin e mëposhtëm:<br>• *Dokumentacion i cili njofton fillimin e punimeve protokolluar pranë AKM-së.*<br>• *Raportet e vetëmonitorimit të kryera sipas kushteve të përcaktuar në VNM-në që subjekti disponon, protokolluar pranë AKM-së.*<br>• *Konfirmimin me topograf të licensuar se aktiviteti ushtrohet brenda kordinatave të përcaktuara në VNM-në që disponon (nuk ka dal nga koordinatat e përcaktuara).*<br>• *Kontestimet mbi konstatimet e trupës inspektuese.*<br>Grupi i inspektimit nuk ka dal me vendimin përfundimtar pasi referuar Nenit 43 të Ligjit 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" ende nuk janë plotësuar afatet ligjore.<br>4. **Nga inspektimi i kryer në subjektin V*** H***, u konstatua se:**<br>Në momentin e inspektimit në subjektin me vendodhje në Fshatin Banje e Re , Klos, Bashkia Cerrik, buzë lumit Devoll, 500m nga ura mbi lumin Devoll. Subjekti shfrytëzon burimin ujor nëntokësor për qëllime teknologjike (në linjën e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | fraksionimit të inerteve ) por nuk është i pajisur me Leje Për Përdorim Burimi Ujor nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore. Neni: 67 . Ligji: Ligji 111/2012 " Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar . Pika: 1.<br>Gjatë inspektimit u konstatuan kamionë të subjektit të cilët depozitonin inerte lumore në mjediset brenda territorit të veprimtarisë. Këto materiale subjekti i merrte në zonën ku po kryente veprimtari për mbrojtjen e brigjeve, sipas kontratës me Nr.21 me objekt “Mbrojtja nga gërryerja , krahu i majtë i lumit Devoll, në NjA Mollas-Cërrik”, lidhur me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Korçë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural., ku u konstatua një eskavator që kryente nxjerrjen e materialeve inerte dhe kamionë që kryenin transportin e inerteve në subjekt. Subjekti nuk na paraqiti Leje apo Autorizim të Leshuar nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore. Neni: 66. Ligji: Ligji 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar. Pika: Komente: Nuk na u vu në disponon leje apo autorizim i posaçëm nga organet e administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore, për ushtrimin e veprimtarive ndërtimore në brigje.<br>Ndaj subjektit u mor masë administrativ kryesor:<br>• *Gjobë 2,000,000 Lekë.*<br><br>Denim administrativ plotësues:<br>o *Subjekti të mos shfrytëzojë burimin ujor pa u pajisur më parë me Lejen e Përdorimit të Ujit.*<br>o *Subjekti të mos ushtrojë veprimtarinë pa u pajisur me Lejet Përkatëse dhe të respektojë kërkesat ligjore.*<br><br>5. ***Subjekti " I****" – me objekt “Në trajtim të shkresës me nr. 705/4 Prot., Datë 15.05.2025”.*** Ne trajim te ankeses se protokolluar prane ARM Berat/Elbasan/Korce me Nr.705/4., Date:15.05.2025, dhe ne zbatim te programit te punes me Nr.705/3, Date:16.05.2025 u krye verrifikimi ne terren i situates. | | |

<table>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>Nga kontrolli i kryer pergjate shtratit te lumit ne zonen ku referohej ankesa, ne shtratin e lumit dhe brigjet e tij u konstatuan 2 ekskavatore CAT te subjektit I*****. Ekskavatoret ndodheshin ne lumin shkumbin ne segmentin perballe kantierit te subjektit. Ne momentin e inspektimit ekskavatoret ishin te fikur, por ne zonen rreth ekskavatorit u konstatuan disa gropa te cilat tregojne qarte qe jane marre inerte lumore. Gjithashtu rruga qe lidh kantierin e subjektit me lumin kishte gjurme kamionash.<br><br>Gjetjet e konstatuara bjen në kundërshtim me ligjin dhe me vendim përfundimtar dhe në zbatim te pikes 1 dhe 2, te nenit 44, te ligjit nr. 99/2024, date 12.09.2024, "Per inspektimin ne Republiken e Shgiperise", per shkeljet e kerkesave ligjore qe perbejne kundervajtje administrative, subjekti i inspektimit denohet me paralajmerim ne inspektimin e pare. Ndaj subjektit është marr masa Dënim Administrativ Kryesor : Paralajmërim, dhe është lënë detyrë “Subjekti te largoje menjehere ekskavatoret nga shtrati i lumit si dhe mos te marre inerte lumore apo te ushtroje veprimtari ne shtarin e lumit apo brigjet e tij, pa u pajisur me pare me lejen perkatese nga organet e menaxhimit te burimeve ujore. - Subjekti te mos ushtroje veprimtari ne kundershtim me ligjin 29/2024 " Per Burimet Ujore" . Te shfrytezoje inerte lumore dhe te mos kryeje veprimtaru te ndaluara ne lume apo brigjet e tij.”</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>14.<br>Nr.<br>4256<br>Prot</td><td>09.03.2026</td><td>1. Lista e plotë e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit (me koordinata ose adresë të</td><td>11.03.2026</td><td>1- Stacionet e monitorimit te cilesise se ajrit urban.<br><table>
<tr><th>Nr</th><th>Stacionet</th><th>Vendndodhja</th><th>Treguesit</th><th>Kordinatat</th></tr>
<tr><td>1</td><td>Tirana Mobile</td><td>AKM,Tiranë</td><td>PM10,$NO_2$, $SO_2$ , $O_3$, CO dhe BTEX</td><td>41°19'49.94"N<br>19° 48'42.55"E</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Tirana Higjena</td><td>Instituti i Higjenës</td><td>PM10,$NO_2$, $SO_2$ , $O_3$, CO dhe BTEX</td><td>41°32'20.00" N</td></tr>
</table></td><td>Përfunduar</td><td>Nuk ka</td></tr>
</table>

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | saktë).<br><br>2. Statusi aktual i secilit stacion: funksional / jashtë funksionit.<br><br>3. Tipet e ndotësve që mat secili stacion (PM2.5, PM10, NO2, O3, etj.).<br><br>4. Cilat janë burimet kryesore që kontribuojnë në nivelet e larta të PM10 dhe NO2 sipas analizave tuaja? | | (see nested table below) | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | 19º82’66.70” E |
| 3 | Tirana MM | Ministria e Mjedisit | PM10, PM2.5 | 41º32’74.20” N<br><br>19º81’80.20” E |
| 4 | Tirana AKM | Agjencia Kombetare e Mjedisit | PM10, PM2.5 | 41º31’51.70” N<br><br>19º81’55.30” E |
| 5 | Durrës | Oborri i shkolles “Jusuf Puka” | PM10/PM2.5, $SO_2$ , $NO_2$ , $O_3$, CO, BTEX | 41°18’50.26 ”N<br><br>19° 26’57.44”E |
| 6 | Shkodër | Oborri i qendres Shendetesore te Reabilitimit te handikapateve mendore | PM10/PM2.5, $SO_2$ , $NO_2$ , $O_3$, CO, BTEX | 42°04’25.13 ”N<br><br>19°31’24.62 ”E |
| 7 | Elbasan | Perpara godines se qarkut Elbasan | PM10, $SO_2$ , $NO_2$ , $O_3$, CO, BTEX | 41°06’39.53 ”N<br><br>20°04’53.96 ”E |
| 8 | Korcë | Oborri i shkolles “Raqi Qirinxhi”. | PM10/PM2.5, $SO_2$ , $NO_2$ , $O_3$, CO, BTEX | 40°37’33.39 ”N<br><br>20° 46’48.76”E |
| 9 | Fier | Oborri i shkolles “Janaq Kilica” | PM10/PM2.5, $SO_2$ , $NO_2$ , $O_3$, CO, BTEX | 40°72’53.70 ”N |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | <table><tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>19°<br>55'50.50"E</td></tr></table><br><br>2-Stacionet janë të gjitha në funksion më përjashtim të stacionit të instaluar te Ministria e Mjedisit ,për arsye teknike të momentit.<br>3-Treguesit që mat secili stacion janë të listuara në përgjigjen e pyetjes numer 1.<br><br>4- Kontribuesit kryesorë që ndikojnë në rritjen e niveleve të NO2 dhe grimcane të pluhurit( PM10,PM2.5) janë trafiku i renduar dhe ndertimi por edhe nga transformimet kimike që ndodhin në atmosferë, ndërsa në  dimër si pasojë e perdorimit të lëndëvë djegëse për ngrohje .<br><br>Situata për ndotësit e tjetrë të monitoruar paraqitet e stabilizuar më ndonjë rritje jo shume të konsiderueshme të O3 në muajt e verës kjo si pasojë e reaksioneve kimike qe ndodhin në ajër ne parani të rrezeve UV në zonat rurale.<br><br>Kjo situatë nxitet nga dy faktorë kryesorë:<br><br>1. *Urbanizimi i lartë në pjesë të konsiderueshme të zonave bashkiake kontribuon në ndotjen e lartë nga trafiku për shkak të lëvizshmërisë së popullsisë.*<br><br>2. *Industria e Elbasanit, Tiranës dhe Fierit.* | | |
| 15.<br>Nr.<br>4505 | 17.03.20<br>26 | Jam pronar i një pusi ekzistues | 19.03.2026 | Pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe lejes te Pus-Shpimit miratuar me vendimin e Këshillit të Basenit Ujor Ishëm | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Prot | | për furnizim me ujë nëntokësor për përdorime të ndryshme, i cili shërben për aktivitetin "Lavazh Automjetesh". Pusi është i pajisur me Leje pus-shpimi, miratuar me Vendim të Këshillit të Basenit Ujor ISHËM. Në vijim të procedurës për aplikimin për Leje Përdorimi të Ujit për qëllime të ndryshme, pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore-Baseni i Ishmit, kërkohet paraqitja e | | nr.17,date 21.12.2022 per subjektin "Sajmir Brari" me koordinata;<br><br>KRRGJSH: X=48 73 15.6; Y=45 78 295.0; Z=148m; H=150m<br><br>Sa më sipër vleresojme se:<br><br>Duke qënë se ky aktivitet është ekzistues, veprimtaria përjashtohet nga procedura e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, bazuar në Ligjin nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar:<br><br>· KREU I, Neni 1, Pika a) qëllimi i tij është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim<br><br>· KREU II, Neni 7, Pika 1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.<br><br>· KREU V, Neni 20, Pika 1. Autoriteti i planifikimit ose autoriteti përgjegjës për licencimin, kur shqyrton dhënien ose jo të lejes së zhvillimit/licencës përkatëse për një projekt, apo vendosjen e kushteve për zhvilluesin, merr në konsideratë vendimin dhe deklaratën mjedisore për ndikimet në mjedis të projektit të propozuar.<br><br>Ju sjellim në vëmendje se, në rast se në objekt do të ketë shtrirje linjë furnizimi uji, apo shfrytëzim të një burimi të ri ujor, atëherë aktiviteti i nënshtrohet procedurës së VNM-së Paraprake në bazë të Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Shtojca II, Pika 10 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumentac -ionit mjedisor përkatës. Në këtë kuadër, kërkojmë sqarimin tuaj zyrtar, nëse për një pus ekzistues i cili ka qenë më parë me leje pus-shpimi, ekziston apo jo detyrimi ligjor për t'iu nënshtruar procedurës së VNM-së paraprake. Referuar shtojcave I dhe II të Ligjit Nr.10440/2011 të ndryshuar rezulton se ky lloj aktiviteti nuk është i listuar ndër veprimtaritë që i nënshtrohen | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | detyrimisht procedurës së VNM-së. | | | | |
| 16. Nr. 4582 Prot | 18.03.2026 | Dëshiroj të marr informacion zyrtar në lidhje me dokumentacionin dhe procedurat e nevojshme për marrjen në përdorim personal dhe sportive të një liqeni me sipërfaqe 0.5 hektarë. Kërkoj informacion mbi:<br><br>- Dokumentat që kërkohen për aplikim<br>-Procedurat ligjore që duhet të ndiqen<br>- Institucionet përkatëse me të cilat | 24.03.2026 | Në vijim të kërkesës ju bëjmë me dije se:<br>Në kërkesë nuk specifikohet aktiviteti që do të kryhet në sipërfaqen e cila synon të përdoret, megjithatë ju bëjmë me dije se AKM-ja shqyrton aplikime në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, aplikime të ardhura në sistemin e_leje, në e_Albania.<br>Nëse aktiviteti i synuar do të jetë aktivitet shërbimi, duhet ti referoheni shtojcave I dhe II të ligjit Nr.10440, për të cilin duhet të aplikoni me pas për VNM Paraprake ose të Thelluar. Pagesa kryhet në varësi të aplikimit. Aplikimi kryhet në e_Albania.<br>Nga sektori i financës nevojitet një informacion se me cfarë leje do pajiset subjekti në varësi të kesaj procedure është tarifa e aplikimit dhe tarifa vjetore e lejes.<br>Për çdo informacion shtesë: referohuni faqes së web-it të AKM-se: www.akm.gov.al | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | duhet të koordinohem<br>-Afatet kohore të shqyrtimit të kërkesës<br>-Cdo tarrifë apo detyrim financiar përkatëse | | | | |
| 17. Nr. 4794 Prot | 19.03.2026 | Doja te dija nese vendimet e komisionit per VNM ka ndonje arsye qe nuk publikohen me, apo publikohen diku tjeter. Qe ne 2025 lejet jane postuar vec per disa muaj, dhe ne 2026 nuk ka patur fare publikime. | 26.03.2026 | Në vijim të informacionit të kërkuar administruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Nr.4794 prot datë 24.03.2026, Bashkëlidhur gjeni linkun e mëposhtëm :<br><br>https://akm.gov.al/cat_doc/vleresimi-i-ndikimit-ne-mjedis/ | Përfunduar | Nuk ka |
| 18. Nr. 4958 Prot | 27.03.2026 | Sa leje mjedisore /VNM janë lëshuar për resorte, hotele etj | 31.03.2026 | Në përgjigje të kërkesës, Ju bëjmë me dije se:<br>AKM-ja shqyrton aplikime në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, aplikime të ardhura në sistemin e_leje, në e_Albania. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | subjekte të Aktit Normativ nr 8/2023 me qëllim "Instalimin e impianteve të ujërave të ndotura" për periudhën Janar 2024 - Mars 2026?<br><br>· Për cilat subjekte?<br><br>· Kopje të lejeve mjedisore/VNM të lëshuara për resorte, hotele etj subjekte të Aktit Normativ nr 8/2023 për Instalimin e impianteve të ujërave të ndotura.<br><br>· A shkaktojnë ndikim në mjedis instalimi i | | Në zbatim të nenit 11 të Aktit Normativ nr 8/2023 me qëllim "Instalimin e impianteve të ujërave të ndotura", subjektet që duhet të ndërtojnë impiant trajtimi sipas këtij akti normativ duhet të pajisen me deklaratë paraprake punimesh sipas Ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar dhe Vendimit nr.408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për rregulloren e zhvillimit të territorit" të ndryshuar dhe të kryejnë "njoftimin për fillimin e punimeve" pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjelles-Kanalizimeve (AKUK). Për sa më sipër subjektet që kanë qënë pjesë e procedurës së përshpejtuar 90 ditore nuk kanë qënë pjesë e procedurave të VNM-së.<br>Në linkun e mëposhtëm janë të publikuara vendimet e dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit:<br>https://akm.gov.al/cat_doc/vleresimi-i-ndikimit-ne-mjedis/<br>Impiantet e ujërave të ndotur janë thelbësore për mbrojtjen e mjedisit, dhe përfitimet e tyre tejkalojnë ndjeshëm ndikimet negative. Pasi trajtimi redukton ndotjen e ujrave, ndihmon në ruajtjen e florës dhe faunës ujore, përmirëson shëndetin publik dhe uji i trajtuar mund të ripërdoret për ujitje, etj.<br>Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C dhe licenca të nënkategorisë III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë".<br>Në linkun e mëposhtëm verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B:<br>https://qkb.gov.al/leje-licensa-autorizime/<br>Në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi Tipi A dhe B dhe licenca III.2.B për periudhën Janar 2014 - Mars 2026:<br>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/<br>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/ | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | impianteve të ujërave të ndotur?<br><br>Kopje të listës të operatorëve privatë apo shtetërorë të licencuar ne transportimin e llumit te krijuar nga impiantet e ujerave te ndotura.<br><br>· A keni dhënë ju një opinion/mendim/koment për trajtimin e ujërave të ndotur urban nga subjektet që janë të lidhur me ujësjellës kanalizimet, në procesin e miratimit të Aktit nr. 8/2023 dhe Udhëzimit nr. 1, dt 01.02.2024 të Ministrisë | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | së Mjedisit dhe Infrastrukturës: “Për miratimin e rregullores teknike për instalimin e ujërave të ndotur”? Nëse po, kopje te dokumentave. | | | | |